

BKSTONE

Platforma e ndërmarrjeve për nxitjen e modernizimit dhe rritjes së qëndrueshme në industrinë e gurit natyror në Ballkanin Perëndimor

610483-EPP-1-2019-1-AL-EPPKA2-CBHE-JP

Përhapja e synimeve të projektit pranë Kompanisë së Gurit

2.1 Takimet e grupit të punës me menaxherin e kompanisë BUCI SHPK, realizuar gjatë periudhës shtator - tetor, 2020

Firma Buci SHPK ka filluar të funksionojë 20 vite më parë. Iniciativë për krijimin e këtij aktiviteti të lidhur me gurin ka qenë tradita familjare, kërkesa e madhe dhe e vazhdueshme e tregut të brendshëm dhe të huaj, si dhe prania e shtresave të gurit në këtë territor, favorizuar nga litologjia e guri gëlqeror.

Menaxheri i kompanisë pohon se nga nxjerrja në gurore deri në përdorim përpunimi i gurit kalon në një seri fazash.

Faza 1. Prerja e gurit (pllaka ose blloqe që vijnë nga vendi i gjurmimitose nga gurorja).

Faza 2. Gurit i jepet forma e dëshiruar (sipas kërkesave të klientit).

Faza 3. Guri skalitet dhe krijohen struktura sipas dëshirës së porositesit.

Faza 4. Vendosja e blloqeve prej guri në struktura mbajtëse për t'i transportuar ato te klienti.

Kompania e cila prej vitesh është e vetmja që i ka rezistuar sfidave të shumta, punon për të gjithë tregun e brendshëm, por jo vetëm. Prioritet për Buci SHPK-në janë tregu evropian, që përfshin: Greqinë, Italinë, Francën, por edhe ai australian.

Për sa i përket kujdesit ndaj mjedisit, kompania merr masa që mbetjet e rrasave të gurit të grimcohen dhe përdoren në prodhimin e llaçit dhe produkteve të tjera të ndërtimit, pa shkaktuar ndotje ose shqetësime mjedisore.

Kompania është e gatshme të bashkëpunojë me Universitetin “Eqrem Çabej”, për sa i përket praktikës mësimore për studentët e ciklit 2-vjeçar, ku do të aplikohen programet e “Menaxhimit të Gurit” të konceptuara në kuadër të projektit BKSTONE, duke u bazuar në specifikën e zonës dhe ofertën e tregut të punës.

Pamjet e proceseve të punës gjatë nxjerrjes dhe përpunimit të gurit në kompaninë Buci SHPK





